


# TaxNews

Nëntor 2017  
November 2017



## I. Shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 953/2014 për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH"

Më poshtë janë përmbledhur shtesat dhe ndryshimet kryesore në VKM për dispozitat zbatuese të Ligjit "Për TVSH-në", shumica e të cilave hyjnë në fuqi më 21.11.2017 (me përjashtim të ndryshimit të kufirit të përgjithshëm të regjistrimit për TVSH, efektiv prej 01.04.2018):

### **Ndryshimi i kufirit të regjistrimit për TVSH**

- a. Duke filluar nga data 01.04.2018, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH për të gjithë personat e tatueshëm (përveç atyre më poshtë në pikën b.) do të jetë qarkullimi vjetor prej 2,000,000 Lekë (deri më atëherë, kufiri minimal i përgjithshëm i regjistrimit për TVSH do të vijojë të jetë qarkullimi vjetor prej 5,000,000 Lekë);
- b. Duke filluar nga data 21.11.2017, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH për prodhuesit bujqësorë që i nënshtrohen skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë është qarkullimi vjetor prej 5,000,000 Lekë;
- c. Duke filluar nga data 21.11.2017, rivendoset kufiri minimal i regjistrimit për TVSH për personat e tatueshëm që kryejnë aktivitet ekonomik në fushën e hotelarisë, njëjloj si për të gjithë personat e tatueshëm të tjerë të përmendur në pikën a. më lart (më parë, këta persona ishin të regjistruar detyrimisht për TVSH pavarësisht nga qarkullimi vjetor).

## I. Additions and amendments to the Decision of Council of Ministers (DCM) no. 953/2014 for the implementing provisions of Law no. 92/2014 "On VAT"

Herein below are summarized the main additions and amendments to the DCM for the implementing provisions of the Law "On VAT", majority of which entered into force on 21.11.2017 (except for the amendment in the VAT registration threshold that will be effective from 01.04.2018):

### **Change of minimum VAT registration threshold**

- a. Starting from 01.04.2018, the minimum VAT registration threshold for all taxable persons (except taxable persons mentioned in letter b.) will be the annual turnover of ALL 2,000,000 (until then, the minimum VAT registration threshold will continue to be the annual turnover of ALL 5,000,000);
- b. Starting from 21.11.2017, the minimum VAT registration threshold for agricultural producers that are subject to the compensation scheme for agricultural producers will be the annual turnover of ALL 5,000,000;
- c. Starting from 21.11.2017, the minimum VAT registration threshold is re-introduced for taxable persons that carry out economic activity in the accommodation industry and is set the same as for all the other taxable persons that carry out economic activity mentioned in the letter a. above (previously, these persons were obliged to register for VAT purposes regardless of the annual turnover).

## **Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e shkallës së reduktuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese**

- Fusha e veprimit

Duke filluar nga data 05.06.2017 (lutemi referojuni Tax News Maj 2017), një normë e reduktuar e TVSH-së prej 6% zbatohet për shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit. VKM sqaron se kjo normë zbatohet vetëm për 'furnizimin e shërbimit të akomodimit', ku përfshihet edhe furnizimi i vaktit të mëngjesit në rastet kur struktura akomoduese e ofron atë brenda çmimit të furnizimit të fjetjes.

- Deklarimi dhe e drejta e zbritjes

Një person i tatueshëm i cili, përveç veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, ushtron edhe aktivitete të tjera, duhet të regjistrohet më vete për veprimtarinë e ushtruar në strukturat akomoduese.

Furnizimi i shërbimit të akomodimit duhet të evidentohet veçmas në faturë dhe të ngarkohet me TVSH në normën e reduktuar 6%.

Ndërsa furnizimet e tjera të furnizuara nga strukturat akomoduese do të ngarkohen me normën standarde të TVSH-së prej 20%.

E drejta e zbritjes së TVSH së paguar në blerje për ofrimin e shërbimit të akomodimit do të jetë e plotë, sipas parashikimeve të Ligjit "Për TVSH-në".

## **Conditions, criteria and procedures for the application of the reduced VAT rate for the supply of accommodation services in the accommodation facilities**

- Scope of action

Starting from 05.06.2017 (please refer to our Tax News May 2017), a reduced 6% VAT rate is applicable to the accommodation services in the accommodation facilities based on the categories specified in the legislation on tourism sector. The DCM clarifies that this rate is applied only for the 'supply of the accommodation services', including also the breakfast when the accommodation facility offers it within the price of the supply of accommodation.

- Declaration and the right of deduction

A taxable person who also carries out other activities apart from the accommodation facilities activity must register separately for the activity carried out in the accommodation facilities.

The supply of the accommodation service should be presented separately in the tax invoice and a reduced VAT rate of 6% should be charged. All the other services supplied in the accommodation facilities will be charged with the standard VAT rate of 20%.

The right of input VAT in relation to the supply of the accommodation service will be available fully, as per the provisions of the Law "On VAT".

## Lehtësi administrative

Në rastin e aplikimit për përfitimin e përjashtimeve nga TVSH (si p.sh. për investime me vlerë mbi 50 milion Lekë, për industrinë e agrobiznesit, përpunimit aktiv etj.), dokumentet, vërtetimet e autorizimet të cilat lëshohen nga vetë institucionet shtetërore nuk do të jenë më të kërkueshme, si p.sh.:

- Ekstrakti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Autorizimi për lejimin e përpunimit aktiv;
- Vërtetim se importuesi është person i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël, etj.

## II. VKM për dispozitat zbatuese të Kodit të ri Doganor

Kodi i ri Doganor, miratuar me Ligjin nr. 102/2014, ka hyrë në fuqi plotësisht më datë 01.06.2017. Në zbatim të tij, Këshilli i Ministrave ka miratuar të gjitha dispozitat zbatuese të tij si të integruara në një VKM të vetme nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 199, datë 17.11.2017. Kjo VKM ka shfuqizuar VKM nr. 205, datë 13.4.1999 për dispozitat zbatuese të Kodit të vjetër Doganor si dhe VKM nr. 919, datë 29.12.2014 për dispozitat zbatuese të miratuara fillimisht në zbatim të Kodit të ri Doganor.

Dispozitat zbatuese të Kodit të ri Doganor kanë hyrë në fuqi më datë 18.11.2017 dhe i shtrijnë efektet nga data 03.12.2017.

## Simplified administrative procedures

In the cases of applications to obtain the exemption from VAT on imports (for example in the case of investments over ALL 50 million, for the agriculture industry, inward processing etc.), the documents, certifications and authorizations that are issued from the governmental institutions themselves will no longer be required, as for example:

- Registration extract with the National Business Center;
- Authorization for permitting the active processing;
- Certificate proving that the importer is a taxable person subject of the small businesses regime, etc.

## II. DCM for the implementing provisions of the new Customs Code

The new Customs Code, approved through Law no. 102/2014, has fully entered into force on 01.06.2017. For purposes of its implementation, the Council of Ministers has approved all of its implementing provisions as integrated in one single DCM no. 651, dated 10.11.2017 "On the implementing provisions of the Customs Code", published in the Official Gazette no. 199, dated 17.11.2017. This DCM has abolished the DCM no. 205, dated 13.04.1999 on the implementing provisions of the previous Customs Code and also the DCM no. 919, dated 29.12.2014 on the implementing provisions approved initially in pursuance to the new Customs Code.

### III. Për shpalljen e disa ndryshimeve në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe

Në Fletoren Zyrtare nr. 201 datë 21.11.2017, është botuar teksti i plotë i disa ndryshimeve në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar (SNK/SNRF) të përkthyer në gjuhën shqipe:

- Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat", me datë efektive 01.01.2017
- SNRF 1 "Përmirësimet vjetore në SNRF-të, periudha 2014-2016", me datë efektive 01.01.2018
- Ndryshime në SNRF 4 "Kontrata e sigurimit", me datë efektive 01.01.2018
- Ndryshime të SNK 7 "Flukset e mjeteve monetare", me date efektive 01.01.2017
- Interpretimi 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj", me datë efektive 01.01.2018
- Ndryshime në SNRF 2 "Pagesa të bazuara në aksione", me datë efektive 01.01.2018
- Ndryshime në SNRF 15 "Të ardhura nga kontrata me klientët", me datë efektive 01.01.2018
- Ndryshime në SNK 40 "Aktiv afatgjatë material i investuar", me datë efektive 01.01.2018.

The implementing provisions of the new Customs Code entered into force on 18.11.2017 and are effective from 03.12.2017.

### III. For the announcement of some amendments in the international accounting standards and financial reporting (IAS/IFRS), translated in Albanian

The Official Gazette no. 201 dated 21.11.2017 has published the complete text of some amendments to the international accounting and financial reporting standards (IAS/IFRS) translated to Albanian:

- Amendments to IAS 12 "Income taxes", effective from 01.01.2017
- IFRS 1 "Annual improvements on IFRSs, 2014-2016 period", effective from 01.01.2018
- Amendments to IFRS 4 "Insurance Contracts", effective from 01.01.2018
- Amendments to IAS 7 "Statement of Cash flows", effective from 01.01.2017
- Interpretation 22 "Foreign Currency Transactions and Advance Consideration" effective from 01.01.2018
- Amendments to IFRS 2 "Share-based Payment", effective from 01.01.2018
- Amendments to IFRS 15 "Revenue from Contracts with Customers", effective from 01.01.2018
- Amendments to IAS 40 "Investment Property", effective from 01.01.2018

#### IV. Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka njoftuar mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjeve të mëposhtme ndërkombëtare:

- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për mbrojtjen shoqërore dhe protokollit përfundimtar të saj hyn në fuqi më 01.12.2017. Marrëveshja është ratifikuar me Ligjin nr. 23/2016, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 49, datë 01.04.2016;
- Konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal mbi tatimin mbi të ardhurat”, hyn në fuqi më 01.01.2018. Konventa është ratifikuar me Ligjin nr. 10 285 datë 03.06.2010, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 02.07.2010.

#### IV. Notification of the Ministry for Europe and Foreign Affairs on the entrance into force of some international agreements

The Ministry for Europe and Foreign Affairs has made an announcement regarding the entry into force of the following international agreements:

- The agreement between the Republic of Albania and the Federal Republic of Germany on the social protection and its final protocol enter into force on 01.12.2017. The agreement has been ratified with Law no. 23/2016, published in the Official Gazette no. 49, dated 01.04.2016;
- The convention between the Government of the Republic of Estonia and the Council of Ministers of the Republic of Albania for the avoidance of double taxation and the prevention of fiscal evasion with respect to taxes on income, enters into force on 01.01.2018. The convention has been ratified by Law no. 10285, dated 03.06.2010, published in the Official Gazette no. 79, dated 02.07.2010.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services

Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit

Gjeologji Miniera

Tirana | Albania

Mob: +355 68 60 33 116

E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 225,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.